



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2713/14 prot.

Datë 04.12.2025

V E N D I M
Nr.1796/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.12.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr. 1710/2025, datë 19.11.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-57162-08-05-2025, me objekt: “Blerje pemë dekorative” me fond limit 12,500,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 21.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Ankimues: Operatori ekonomik “AlbGarden” SHPK me NIPT K37513520N dhe adresë: Lagjja "Skenderbeg", Lezhë, godinë private 1 kateshe, në superstradën Lezhë - Shkodër, km 1.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Durrës.
Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës.

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Agro-Korani” SHPK me NIPT L13329801V dhe adresë: Kavaje Helmes Tiranë Helmes, Shtodher, Ndërtesë 1 katëshe, pranë urës së Draxhit.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i

ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 19.11.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1710/2025 ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albgarden” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-57162-08-05-2025, me objekt: “Blerje pemë dekorative” me fond limit 12,500,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 21.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.*
2. *Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik “Agro Korani” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentur veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “AlbGarden” SHPK*
5. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 7122 prot., datë 26.11.2025 protokolluar me tonën nr. 2713/11 prot., datë 02.12.2025 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.1710/2025 datë 19.11.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-57162-08-05-2025, me objekt: “Blerje pemë dekorative” me fond limit 12,500,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 21.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1 Me shkresën nr. 7122 prot., datë 26.11.2025 protokolluar me tonën nr. 2713/11 prot., datë 02.12.2025 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.1710/2025 datë 19.11.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-57162-08-05-2025, me objekt: “Blerje pemë dekorative” me fond limit 12,500,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 21.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.1710/2025 datë 19.11.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se, autoriteti kontraktor ka rivlersuar procedurën e prokurimit object ankimi, në zbatim të vendimit Nr.1710/2025 datë 19.11.2025, të këtij komisioni.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-57162-08-05-2025, me objekt: “Blerje pemë dekorative” me fond limit 12,500,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 21.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

